



SEECP ALBANIAN CHAIRMANSHIP
REGIONAL OWNERSHIP IN ACTION

DEKLARATË E PËRBASHKËT E SEECP-SË MBI TERRORIZMIN

Tiranë, 24 shkurt 2015

Ne, Ministrat e Punëve të Jashtme të vendeve pjesëmarrëse të SEECP, gjatë takimit në Tiranë më 24 shkurt 2015, në prani të përfaqësuesve të Presidencës letoneze të BE-së, Komisionit Evropian, Austrisë dhe Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC),

Të vetëdijshëm se terrorizmi përbën një kërcënim të drejtpërdrejtë ndaj paqes, sigurisë dhe stabilitetit në rajonin tonë, Evropë dhe në pjesën tjetër të botës dhe duke u zotuar të bashkojmë forcat tona për të luftuar kundër tij, siç u vërtetua së fundmi nga ngjarjet tragjike në Paris;

Të ndërgjegjshëm se terrorizmi përbën një pengesë serioze për gëzimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;

Duke kujtuar deklaratat dhe rezolutat mbi kundër-terrorizmin në kuadër të OKB-së, OSBE-së, Këshillit të Evropës, BE-së dhe NATO-s;
Duke shprehur keqardhjen dhe solidaritetin tonë të përzemërt për viktimat e terrorizmit;

Të shqetësuar për përhapjen e fenomenit të luftëtarëve të huaj terroristë dhe qelizave terroriste në Evropë dhe gjetkë;

Ramë dakord si më poshtë:

1. Të dënojmë fuqimisht të gjitha aktet, metodat dhe praktikat e terrorizmit dhe të rikonfirmojmë vendosmërinë tonë për të luftuar terrorizmin në të gjitha format dhe manifestimet e tij.
2. Të dënojmë fuqimisht aktet e tmerrshme terroriste dhe mizoritë e kryera nga ISIL / DAESH dhe organizata të tjera terroriste, si dhe shkelje të tjera të rënda të të drejtave të njeriut dhe së drejtës ndërkombëtare.
3. Të theksojmë se terrorizmi nuk ka justifikim, pavarësisht arsyes apo origjinës së tij, dhe nuk mund e nuk duhet të jetë i lidhur me asnjë kombësi, fe apo grup etnik të caktuar.
4. Të shprehim bindjen tonë të plotë se kërcënimet dhe sfidat e përbashkëta kërkojnë përgjigje dhe veprime të përbashkëta.

5. Të ritheksojmë angazhimin tonë për të intensifikuar bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit dhe për të adresuar fenomenin e luftëtarëve të huaj terroristë përmes përpjekjeve të koordinuara në të gjitha fushat përkatëse.
6. T'i kërkojmë Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal për të punuar në përgatitjen e një platforme të bashkëpunimit rajonal, e cila do të sillte së bashku të gjitha palët kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare të interesuara, për të arritur një qasje të përbashkët mbi çështjen e terrorizmit dhe luftëtarëve të huaj terroristë.
7. Të shprehim mbështetjen tonë për Koalicionin Global kundër terrorizmit dhe të zotohemi për forcimin e bashkëpunimit përmes të gjithë mekanizmave të duhur me partnerët evropianë dhe ndërkombëtarë, për të parandaluar dhe luftuar aktet terroriste.
8. Të shprehim shqetësimin tonë në lidhje me përshkallëzimin e kërcënimeve terroriste në zona të caktuara të jugut të Evropës, duke bërë thirrje për zgjidhje të mirëfilltë politike e duke adresuar rrënjët kryesore të paqëndrueshmërisë dhe ekstremizmit.
9. Të ritheksojmë se lufta kundër terrorizmit është një çështje shumëdimensionale, jo thjesht një çështje e sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare, drejtësisë dhe inteligjencës; të rikonfirmojmë vullnetin e vendosmërinë tonë për të rritur më tej bashkëpunimin rajonal, me qëllim forcimin e shtetit të së drejtës dhe zbatimin e politikave që nxisin zhvillimin ekonomik, rininë, arsimin, mundësitë dhe aksesin e barabartë në shëndetësi e në tregun e punës.
10. Të promovojmë tolerancën dhe bashkëjetesën fetare si kontribute të drejtpërdrejta për demokratizimin, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, sigurinë dhe stabilitetin në rajonin tonë dhe parandalimin e radikalizimit dhe akteve ekstremiste.